



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 20-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 30. 07. 2015 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi , anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Ragip Zejnullahu, anëtar
20. Nazmi Krasniqi anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkovic anëtar
31. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
3. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
4. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF
5. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
6. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
7. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
8. Latif Ramadani, Drejto i DEZH
9. Avni Olluri, Drejtor i DGJK
10. Feti Krasniqi,
11. Remzi Mehmeti,
12. Ilir Tasholli,
13. Imer Rrustemi Drejtor i DI
14. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
15. Vlora Krasniqi, zyra ligjore
16. Qëndresa Jashanica,
17. Venera OSBE-se
18. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
19. Bekim Krasniqi, "YHR"
20. Bukuriye Zejnullahu, zyra për informim
21. Përfaqësuesit e mediave
22. Numër i konsideruar i qytetarëve

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti Sami Murati.

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë dhe për këtë mbledhje kemi 9 pika të rendit të ditës dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës.

Pastaj pyeti anëtarët se kush është për këtë rend dite?

Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për për punën e kësaj mbledhje miratoi këtë

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 19-të e KK-së
2. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës
3. Raporti i buxhetit të alokuar dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve kategorive ekonomike dhe programeve për 6 mujorin e vitit 2015 të Komunës së Lipjanit.
4. Raporti i auditimit dhe pasqyrat financiare të Komunës së Lipjanit për vitin përfundimtar me 31. dhjetor 2014 i auditorit të përgjithshëm.
5. Propozimi i Rregullores për shfuqizimin e Rregullores 15Nr. 464-4251 për përcaktimin e qirasë për dhënjën në shfrytëzim të tokës bujqësore, banesave dhe lokaleve afariste në pronësi të Komunës së Lipjanit të datës 12. 03. 2013.
6. Propozim Vendimi për fillimin e iniciativës dhe veprimeve përgaditore për aplikim në MTI për marrjen e pëlqimit për themelimin e Zonës Ekonomike në Zonën Kadastrale Qylagë.
7. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për shkollën e mesme Gjumnazi "Ulpiana" në Lipjan.

8. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për shkollën fillore e mesme e ulët “Emin Duraku” Banullë-Glllogovc.
9. Propozim Vendim për dhënjën në shfrytëzim të tokës pasuri-shoqërore e KK-së Lipjan, KB-is (Këshilli i Bashkësisë Islame) për ndërtimin e objektit për të pame për banorët e fshatit Kraishtë.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 19-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 19-të të Kuvendit?

Merita Zeqiri, kam vërejtje në ekstraktin e mbledhjes së kaluar ku te diskutimi im lidhur me ceremoninë e organizimit të maturës për semimaturant është ndërruar emri dhe është thënë “Ismajl Luma” a duhet të jetë në shkollën “Vëllëzërit Frashëri” ku punoj unë gjithashtu nuk kam thënë se nuk e di se kush ka intervenu te policia se kjo është ditur por kam thënë se nuk ka qenë arsye e mjaftueshme për të dhënë ultimatum që policia t’i nxjerr me dhunë nxënësit nga shkolla. Vërejtje tjetër kam te Vendimi për aprovimin e kornizës afatëmesme buxhetore te investimet kapitale ku lidhen me projektet për Hallaq të Madh dhe nuk kam thënë që trotuarët duhet të jenë prej Hallaqit të Madh në Hallaq të Vogël por kam thënë pasi në këto dy fshatra ka shumë udhëtarë që udhëtojnë në këmbë deri në Lipjan janë të domosdoshme trotuarët.

Pasi vërejtje tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim ekstraktin me vërejtjen e Merita Zeqirit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi, me 31 vota për, aprovoi

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 19-të të Kuvendit me vërejtjen e Merita Zeqirit.

Shtesë: Ekstrakti.

II

Raporti i punës së Kryetarit të Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Imri Ahmetit, Kryetar i Komunës i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe më pastaj tha se këtë raport kemi pasur obligim ligjor për të paraqit në Kuvend dhe besoj se raportin e keni marrë me kohë dhe nuk dua të lexoj për shkak të kursimit të kohës dhe ju njoftoj se unë jam i kënaqur me punën e drejtorëve për periudhën raportuese dhe për këtë tregojnë indikatorët matës. Fillimisht po filloj në realizimin e të hyrave dhe sigurisht e keni pa në raport se të hyrat janë realizu me 54%, gjithashtu niveli i shpenzimeve është realizu me 67%.

Te investimet kapitale realizimi i tyre nuk është në nivelin e dëshiruar por besoj se në 9-të mujor realizimi i investimeve kapitale do të jetë mbi 80% mos të them 100%. Në vazhdim tha se na nuk kemi lidh asnjë kontratë mbi zotimin e mjeteve por gjatë lidhjes së

kontratave kemi pasur edhe mbetje të mjeteve dhe këto mjete do t’i ridestinojmë në projekte të reja në vijim.

Projektet që kanë filluar në vitet e mëhershme siqë është kanalizimi në Gadime e shumë projekte tjera që kanë mbetur në gjysëm shumica prej tyre deri në fund të vitit do të përfundojnë.

Pastaj tha se ne do të vazhdojmë për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale si të tokave ashtu edhe të lokaleve sipas procedurave të parapara me Ligj. Në vazhdim tha se shumë shfrytëzues që kanë marrë pronat komunale në shfrytëzim dhe kurr nuk kanë përmbush obligimet ndaj Komunës ne do t'i shkëpusim ato kontrata. Në fund tha se të hyrat vetanake janë rritur duke fillu prej zyrës pritëse e të gjitha departamentet tjera.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtua këtë raport dhe falenderojmë Kryetarin për paraqitjen e këtij raporti si dhe të arriturat që janë bërë gjatë periudhës raportuese.

Florent Hoxha, edhe na e kemi shqyrtuar këtë raport dhe është obligim ligjor paraqitja e këtij raporti në Kuvend.

Pastaj tha se Kryetari përmendi sukseset që i kanë përcjellë gjatë periudhës raportuese në të gjitha dikasteret që na si opozitë nuk kemi mund me i përcjellë por konsideroj se ka pasur edhe mangësi gjatë punës së këtyre dikastereve dhe si shembull po e marr ndërrimi i vendeve të punës të disa zyrtarëve ku ka pasur shkelje ligjore dhe këtë e ka konstatu edhe këshilli i pavarur mbikëqyrës.

Te investimet kapitale për periudhën raportuese ka pasur ngecje dhe këtë e kemi thënë edhe në KPF e gjithashtu edhe Kryetari tha se ka ngecje por për 9-të mujorë ju premtoj se planifikimet për investime kapitale do të realizohen. Në vazhdim përmendi se shërbimet në shëndetësi nuk kanë qenë në nivel e sidomos në disa ambulanca ku ka ankese edhe nga qytetarët. Pastaj përmendi lidhjen e kontratave me operatorë të shtrenjët si dhe lidhjen e kontratave mbi zotimin e mjeteve dhe për këtë i kemi edhe argumentet a dihet se ky ekzekutiv disa herë ka deklaruar se nuk do të ketë lidhje të kontratave pa zotim të mjeteve.

Në bujqësi e dimë se ka pak mjete për subvencione por edhe ndarja e tyre nuk ka qenë transparente e ka edhe ankesa për këtë ndarje.

Edita Gashi, foli lidhur me ramjen e suksesit të nxënësve, mungesat e mëdha të nxënësve ku shihet se për çdo nxënës mesatarja e mungesave është 30 mungesa për nxënës dhe me 30 mungesa mund të përjashtohet nga shkolla. E gjithashtu testi i kalushmërisë ka qenë i ulët ku në Shalë 66 nxënës nuk e kanë dhënë testin dhe për të gjitha këto shprehim shqetësimin tonë.

Nazmi Krasniqi, jam i pakënaqur me punën e Kryetarit se në fillim ka thënë se unë do të bazohem në Zotin dhe ligjin. Te Zoti nuk do të përzihem por Kryetari ka bërë shkelje të ligjit, andaj kërkoj që në 6 mujorin e dytë të përmirësoj këto shkelje edhe pse ndoshta Kryetari nuk është fajtorë për të gjitha këto shkelje.

Te shkolla e mesme suksesi ka rënë 25% dhe krejtë kjo ka ndodh për shkak se nga shkolla e mesme janë larguar punëtorët që kanë qenë me mbi 25 vjetë përvojë pune.

Petrit Kelmendi, te investimet kapitale për periudhën raportuese ka ngecje sidomos nga grantet qeveritare kurse te të hyrat vetanake do të shihet sakt pas faljeve të borxheve sipas vendimit të qeverisë.

Te shpenzimet e derivateve të naftës është mbi 10 litra të shpenzuara dhe nuk e di se a është në përputhshmeri me kilometrat e kaluara.

Në faqen 46 të raportit te pozicioni i pagave dhe medijëve janë paraqit edhe investimet kapitale dhe disa shpenzime tjera dhe unë konsideroj se këto janë gabime teknike të cilat i kam vërejtë.

Blerim Gashi, ky raport tregon punën që është bërë dhe konsideroj se ka vend edhe për punë më të mirë por në përgjithësi është një raport i mirë edhe pse vërejtjet e opozitës mund të jenë relevante. Në vazhdim pyeti se a kemi ndonjë studim fezibiliteti për formimin e kompanive të patritit, ujësjellësit dhe kanalizimit meqë po kemi probleme posaqërisht për furnizim me ujë.

Te investimet kapitale nuk jam i kënaqur sidomos me projektin për rrugën katër korsi ku punët janë duke u zvarritur shumë dhe qytetarët nuk i dinë arsyet e zvarritjes.

Për planet rregulluese që 2 vite Drejtoria e Urbanizmit nuk ka bërë asnjë hap gjithashtu tregu i gjelbërt është dashtë me dislok. Për stacionin e autobusave e di se nga AKP-ja është bartë në kopetencë të Komunës dhe kërkoj të njoftohemi nga Kryetari.

Ragip Zejnullahu, mendoj se është një raport i varfër sidomos te Drejtorati i Prokurimit meqë fare nuk janë paraqitë se kujt ju kanë dhënë kontratat dhe mënyrën se si u janë dhënë punët kompanive.

Arben Bahtiri, unë mendoj se Kryetari së bashku me ekzekutivin kanë paraqitë një raport që pasqyron gjendjen reale të punës dhe reflekton transparencën e Komunës. Unë kisha me i dhënë disa rekomandime që në të ardhmen të rriten mjetet për subvencione në bujqësi e gjithashtu në Kulturë, Rini dhe Sport meqë janë formu federatat për sporte të ndryshme dhe janë pranuar ndërkombtarisht dhe kemi sportist që na përfaqësojnë edhe në gara përfundimtare. Pastaj kërkoj që në bashkëpunime me Bashkësinë Islame të shqyrtohet mundësia e pastrimit të varrezave meqë varrezat janë pasqyrë e kulturës. Gjithashtu propozoj që të shqyrtohet mundësia e ndërtimit të këndeve për lojrat e fëmijëve dhe fushave sportive etj.

Imri Ahmeti, unë falenderoj diskutuesit dhe them se e përgjithshmja – gjeneralja është mirë dhe në imtësira nuk jam lëshuar. Unë e dëgjova Florentin kur tha se është një tejkalim për 1 mijë euro të një kontrate të nënshkruar dhe menjëherë e angazhova Visarin që ta gjenë këtë tejkalim. Gjithashtu u përmend politizimi në disa qështje dhe unë jam kundër politizimit dhe nuk do ta lejoj këtë e gjithashtu ftoj të gjithë ata që dinë ku ka politizim ta denoncojnë menjëherë këtë.

Unë e di se në mandatin e kaluar janë nënshkruar kontratat mbi zotimin e mjeteve.

Sa i përket ujësjellësit dhe rrugës 4 korsi e dini edhe ju se për atë rrugë kontrata është lidhur për 2.800 mijë euro dhe ka probleme pronësore dhe këto probleme i kemi trashëgu nga e kaluara. Sa u përket planeve rregullative ju njoftoj se nuk ka ndodh ndonjë plan i ri dhe është në fuqi plani rregullativ që është aprovu më herët.

Tregu i gjelbërt nuk është transferu për shkak të disa procedurave me AKP-në.

Te subvencionet jemi më mirë se sa ka qenë më herët.

Ragip Zejnullahu, nuk është mirë që sa herë që dëshirojmë t'i ikim të vërtetës thirremi në të kaluarën dhe u përmend dhënja e pronave në shfrytëzim dhe unë ju them se ekziston dokumentacioni se si janë dhënë këto prona në vitin 2009 dhe janë kërkesat në dosje për kthimin e tyre.

Florent Hoxha, na edhe herën e kaluar kemi përmend ndërtimet pa leje dhe mbrenda kësaj periudhe ka pasur ndërtime pa leje dhe është mirë që për këto të mirren masat dhe procedurat ligjore.

Imri Ahmeti, nuk i kam këqyr dosjet e ndërtimeve pa leje në të kaluarën dhe për pyetjen që ke bërë Florent është objekti i 7 Vllëzërve që është ndërtu dhe kjo është problem dhe a ja vlenë që të rrënojmë. Sa i përket formimit të kompanive shërbyese ujësjellësit, pastrimit etj ekziston Ligji dhe Komuna ka dhënë pëlqim për Ndërmarrjen "Pastrimi" e cila është regjionale kurse për ujësjellësin nuk mund të formojmë kompani meqë kjo është rregulluar me Ligj.

Meqë diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike, e me propozim të Kryesueses u kalua në pikën e tretë

Shtesë : Raporti.

III

Raporti i buxhetit të alokuar dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve kategorive ekonomike dhe programeve për 6 mujorin e vitit 2015 të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdini Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i buxhetit të alokuar dhe shpenzimit në bazë të burimit të mjeteve, kategorive ekonomike dhe programeve për 6 mujorin e parë të vitit 2015 të Komunës së Lipjanit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, tha se për këtë periudhë raportuese buxheti është shpenzu mirë në të gjitha kategoritë me përjashtim të investimet kapitale mirëpo dihet se realizimi i investimeve kapitale fillon pas 3 mujorit të parë, andaj konsideroj se në periudhën e ardhshme shpenzim të investimet kapitale do të jet shumë i mirë. Në vazhdim foli lidhur me realizimin e të hyrave sipas gategorive ekonomike të buxhetit.

Petrit Kelmendi, ky raport ishte pjes e raportit të punës së Kryetari në vijat e trasha, mirëpo në këtë raport ka mungu se sa kanë qenë shpenzimet për mirë mbajtjen e veturave.

Ali Stublla, pyeti lidhur me të hyrat nga dy tregjet kush i realizon ato mjete dhe sa është shuma e tyre meqë gjerë me tani asnjëherë nuk jemi njoftu për këto mjete. Te lejet e ndërtimit në mbledhjen e kaluar planifikimi ka qenë 200 mijë euro kurse tani janë vetëm 100 mijë euro.

Nazmi Krasniqi, buxheti i planifikuar sigurisht se do të realizohet por është shumë me rëndësi të dihet gjendja në teren se si janë realizu ato projekte dhe si është kualiteti i punëve. Unë disa herë e kam përmend qështjen e kontinjerëve nëntokësorë i cili është realizu por tani nuk janë funksional.

Ragip Zejnullahu, disa herë u tha se në 3 mujorin e parë nuk mund të fillon realizimi i projekteve dhe për këtë shkalla e realizimit të investimet kapitale është e ulët por unë e di se procedurat e prokurimit mund të fillojnë me 2-3 janar me një kërkesë të zyrtarit administrativ por dihet kontrata nuk guxon me u lidh pa zotim të mjeteve.

Florent Hoxha, na kemi diskutu edhe në KPF për shpenzimet e buxhetit si dhe ngecjet që kanë qenë në realizimin e shpenzimeve. U tha se në tëësi buxheti për këtë 6 mujor është realizu me 69% mirëpo sipas shpenzimeve të raportit shihet se në 3 drejtori ka ngecje të realizimit të shpenzimeve ku përqindja është shumë e ulët por besoj se në 6 mujorin e dytë kjo përqindje do të rritet në mënyrë që mjetet nuk do të shkojnë në suficit sidomos mjetet nga granti qeveritar.

Pastaj foli lidhur me heqjen e obligimeve që ka pasur komuna ndaj kompanive dhe dihet se këto mjete nuk kanë shku në xhepat e dikujt por janë paguar si nga thesari ashtu edhe nga Komuna. Në fund foli lidhur me realizimin e përqindjeve të të hyrave vetanake si nga tatimet ashtu edhe nga taksat e ndryshme.

Shkelzen Hajdini, ishte një rekomandim që në raport të futen edhe shpenzimet e veturave, shpenzimet e karburanteve e disa tjera dhe ju njoftoj se na kemi pasur për qëllim ruajtjen e kohës për juve me që sikur të futen të gjitha shpenzimet atëherë do të ishte një raport shumë i madh, mirëpo raportin e kemi paraqitë sipas asaj qka kërkohet me Ligj.

U pyet për të hyrat nga tregjet dhe këto të hyra i kemi paraqit në raport. Në vazhdim foli lidhur me kursimet që janë bërë si në shpenzimet e derivateve të naftës, në telefoni etj.

Pasi diskutime tjera nuk pati fjalën e mori Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni dhe shtoi se na e kemi bërë traditë me votu për raportin e shpenzimeve por nuk është obligim ligjor andaj nuk po e vej në votim raportin.

Pas përfundimit të kësaj pike në ora 12²⁰, Kryesuesja dha pauzë deri në ora 13²⁰.

Pas pauzës në ora 13⁴⁰, pas konstatimit se në sallë prezentojnë shumica e anëtarëve dhe se ekziston kuorumi për punë, Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së katër

Shtesë: Raporti i buxhetit.

IV

Raporti i auditimit dhe pasqyrat financiare të Komunës së Lipjanit për vitin përfundimtar me 31. dhjetor 2014 i auditorit të përgjithshëm.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdini Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i auditimit dhe pasqyrat financiare të Komunës për vitin 2014 të auditorit të përgjithshëm.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, na e kemi pranë këtë raport dhe e kemi shqyrtu dhe sipas opinionit të auditorit shihet se menagjeri i Komunës ka dizajnu një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu auditori me theks të veçantë ka paraqitë pagesat e borxheve në shumë mbi 649.641,00€. Në vazhdim foli lidhur me auditimet që janë bërë në të gjitha drejtorit duke dhënë edhe rekomandime dhe na nuk mundemi me e kontestu raportin e auditorit.

Florent Hoxha, na e kemi shqyrtu këtë raport dhe rekomandimet e auditorit e obligojnë Kryetarin që të eliminojë lëshimet që janë bërë dhe atë deri në fund të vitit. Pastaj tha se auditori nuk mund të kontrollojë të gjitha lëndët por është e paraparë me Ligj për përqindjen se sa lëndë do të kontrollojë dhe rekomandimet janë dhënë për ato lëndë ndërsa nuk do të thotë se ato lëndë që nuk janë kontrolluar nuk ka lëshime. Në vazhdim tha se edhe në KPF kam theks se drejtoritë në bazë të rekomandimeve duhet të bëjnë edhe planin e veprimit.

Pastaj tha se auditori ka paraqitë shkeljet në dhënien e punës operatorëve me oferta të pa kompletuara.

Te tatimi në pronë e kemi diskutu edhe qështjen e pagesave të tatimit me këste dhe kemi raste kur obliguesi i tatimit të programuar e ka paguar vetëm këstin e parë kurse këstet tjera nuk i ka paguar fare. Ky opinion që ka dhënë auditori është i mirë por ka edhe gabime dhe besoj se rekomandimet e auditorit nëse zbatohen do të përmirësojnë menaxhimin financiar.

Blerim Gashi, na jemi dëshmitar se që 3 vite sipas auditorit ka pasur keqmenaxhim të buxhetit, me gjithëse vitin e kaluar ka pasur përmirësime. Unë inkurajoj drejtorit dhe kërkoj që në të ardhmen të zbatohen rekomandimet e auditorit në mënyrë që në vitin e ardhshëm përfomanca të del me e mirë.

Petrit Kelmendi, unë besoj se në raport janë dhënë të gjitha shkeljet që ka gjetë auditori dhe ka dhënë rekomandimet vetëm se duhet të zbatohen këto rekomandime.

Ali Stublla, tha se në Drejtorin e Prokurimit ka shkelje sistematike si shembull po e marr se është nënshkruar një kontratë në shumë prej 80 mijë euro me operatorin që nuk i ka plotësuar kushtet nuk e ka pasur verifikimin nga administrata tatimore e dokumente tjera dhe me këtë është bërë shkelje ligjore. Pastaj përmendi se në ndërtimtari nga zyra e prokurimit nuk përdoren librat e ndërtimit andaj për të ardhmen kërkoj të përdoren librat e ndërtimit në mënyrë që mos të ketë keqpërdorime.

Edita Gashi, po e përmendi disa nga të gjeturat jo pozitive të konstatuara në raport si shembull për të hyrat në shumë prej 90 euro, pagesat që janë në mënyrë manuale ku ka mund të ketë dyshime për keqpërdorime blerje të shpeshta minimale, pagesat e lehonave me 100% të cilat mund të lënë dyshime se këto mjete janë dhënë për interesa partiake apo është në pyetje nepotizmi. Në fund tha se është mirë që rekomandimet e dhëna nga auditori të zbatohen me përpikëri.

Nazmi Krasniqi, shihet se është një raport i mirë, por dihet se auditori nuk ka mundësi t'i gjejë të gjitha shkeljet meqë nuk ka mundur t'i kontrolloj të gjitha lëndët por aty ku janë gjetë shkeljet janë dhënë rekomandimet vetëm se duhet të zbatohen dhe me zbatimin e tyre sigurisht do të jetë një menagjim më i mirë.

Meqë diskutimet tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni tha se për raport nuk votohet andaj propozoj që të vazhdohet në pikën e pestë.

Shtesë: Raporti.

V

Propozimi i Rregullores për shfuqizimin e Rregullores 15Nr. 464-4251 për përcaktimin e qirasë për dhënien në shfrytëzim të tokës bujqësore, banesave dhe lokaleve afariste në pronësi të Komunës së Lipjanit të datës 12. 03. 2013.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Latif Ramadanit Drejtor i DEZH-së i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Florent Hoxha, këtë Rregullore e kemi shqyrtuar edhe në KPF dhe kjo Rregullore shfuqizon Rregulloren e mëparshme ku me atë Rregullore qmimi më i ulët për lokale afariste ka qenë 4 euro m2 edhe pse ka pasur ankand publik për dhënien në shfrytëzim të lokaleve në pronësi të Komunës por për shkak të qmimit të lartë nuk ka konkorruar askush. Në vazhdim pyeti Drejtorin se a është bërë ndonjë analizë për caktimin e qmimit më të ulët si bazë fillestare apo sipas kësaj Rregullore qmimi mbetet zero.

Pastaj tha se sipas Rregullores së kaluar janë dhënë toke në shfrytëzim e gjithashtu edhe lokale dhe dashta ta pyes Drejtorin se shfrytëzuesit të cilët kanë paguar obligimet ndaj Komunës a do t'u shkëputen kontratat sipas kësaj Rregullore. Pastaj tha se është mirë si te tokat ashtu edhe te lokalet qmimi të caktohet sipas zonave.

Daut Azemi, na si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë Rregullore e gjithashtu edhe Drejtori e arsyetoi pse duhet të shfuqizohet Rregullorja e mëparshme, andaj ne si grup parlamentar e pëkrahim këtë propozim Rregullore.

Blerim Gashi, unë e kam shqetësimin se na po e shfuqizojmë një Rregullore në të cilën kanë qenë disa kushte dhe me këtë Rregullore nuk po rregullohet asnjë qështje.

Ali Stublla, na i kemi pas disa herë këto Rregullore dhe është mirë që lokalet që posedojnë apo pronat t'i japim në shfrytëzim.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Rregullores dhe pas votimit konstati se me 28 vota për asnjë kundër dhe asnjë apstenim Kuvendi miratoi këtë:

Rregulloren

Për shfuqizimin e Rregullores 15Nr. 464-4251 për përcaktimin e qirasë për dhënien në shfrytëzim të tokës bujqësore, banesave dhe lokaleve afariste në pronësi të Komunës së Lipjanit të datës 12. 03. 2013.

Shtesë: Rregullorja.

VI

Propozim Vendimi për fillimin e iniciativës dhe veprimeve përgatitore për aplikim në MTI për marrjen e pëlqimit për themelimin e Zonës Ekonomike në Zonën Kadastrale Qylagë.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Latif Ramadanit Drejtori i DEZH i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Linda Shahini, na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë prozim Vendim dhe e përkrahim në tërësi e gjithashtu e ftoj edhe opozitën ta aprovoj këtë Vendim.

Florent Hoxha, edhe na si grup parlamentar e kemi shqyrtukëtë propozim Vendim dhe jemi të interesuar të zhvillojmë këtë zonë ekonomike në ZK Qylagë meqë me zhvillimin e saj krijohen mundësit për punësim. Në vazhdim tha se e kemi shpallë këtë vend zonë ekonomike e cila përfshin 142 ha kurse tani me këtë Vendim po shihet se janë parapa vetëm 56 ha dhe nuk e di se qka do të ndodh me pjesën tjetër të cilat nuk janë përfshi në këtë Vendim. Pastaj tha se në bazë të këtij Vendimi Qeveria ka nxjerr një Vendim i cili ka obligu Ministrinë për dhënien e pëlqimit për këtë zonë ekonomike e deri ku ka shkuar kjo punë nuk e di.

Latif Ramadani, Komuna e ka shpall me Vendim zonë ekonomike më herët dhe ky vendim tani nuk e shfuqizon Vendimin e mëparshëm. Sa i përket Vendimit të Qeverisë unë nuk e kam parë atë Vendim.

Blerim Gashi, në momentin kur ne e qojmë këtë Vendim në Ministri mos po na kthehet si lëndë e pa kompletuar se na po e zvogëlojmë e cila më herët është shpallë zonë ekonomike.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimt dhe pas votimit me 29 vota për Kuvendi miratoi këtë:

V E N D I M

PËR FILLIMIN E INICIATIVËS DHE VEPRIMEVE PËRGATITORE PËR APLIKIM NË MINISTRINË E TREGTISË DHE INDUSTRIËS PËR MARJEN E PËLQIMIT PËR THEMELIMIN E ZONËS EKONOMIKE NË ZONËN KADASTRALE QYLAGË

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Vendim, fillohet iniciativa për kryerjen e veprimeve përgatitore për aplikim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për marrjen e pëlqimit për themelimin e zonës ekonomike, me qëllim të funksionalizimit të Zonës ekonomike me status ekonomik "Park industrial" në vendodhje në ngastrën kadastrale P- 71409090-00476-0, në pronësi shoqërore KK. Lipjan, në sipërfaqe prej 56.27.56 ha, Zona kadastrale Qylagë të shpallur me Vendimin e Kuvendit të Komunës për shpalljen e zones ekonomike në kuadër të ZK-Poturovc dhe ZK- Qylagë 1Nr.313-480 të datës 04.05.2010.

Qëllimi i miratimit të këtij Vendimi është një ndër parakushtet e përcaktuara me dispozita ligjore për aplikim në Ministrinë e tregtisë dhe industrisë për t'u pajsur me pëlqim për themelimin e zonës ekonomike.

Qëllimi dhe destinimi i themelimit të kësaj Zone ekonomike është që të bëhet inkurajimi i investitorëve për investime në territorin e Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Obligimet e Drejtorateve Komunale

1. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit obligohet që të ndërmerr të gjitha veprimet që vendodhja e Zonës Ekonomike të jetë në përputhshmëri me Planin hapësinor dhe Planin rregullues urban të Komunës.
2. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm, poashtu obligohet që të ndërmerr të gjitha veprimet që të harmonizojë kushtet e përgjithshme të planifikimit dhe rregullimit të hapësirës të zonës e cila do të jetë pjesë integrale e Zonës Ekonomike si terësi me planin zhvillimor komunal.
3. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim në bashkëpunim me Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoratet tjera relevante obligohet që të përgadisë dokumentin mbi arsyeshmërinë ekonomike, fiskale, mjedisore dhe administrative për themelimin e zonës ekonomike në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-159 për Zonat Ekonomike dhe Udhëzimit administrativ (MTI) Nr.01.2014 për përcaktimin e procedurës së paraqitjes së kërkesës për marrjen e pëlqimit, procedimit të saj dhe dhënien e pëlqimit, mënyrën dhe procedurat për konsultim publik, si dhe përmbajtja e regjistrit të zonave ekonomike.

Neni 3

Organizimi i konsultimit me publikun

Obligohen Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të organizojnë konsultimin me publikun në vendodhjen e propozuar për themelimin e Zonës ekonomike dhe të hartojnë raport mbi konsultimin me publikun i cili bashkë me dokumentacionin e nevojshëm duhet ti paraprijë procedurës të marjes së pëlqimit dhe miratimin e Vendimit për themelimin e Zonës Ekonomike.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për shkollën e mesme Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Ilir Tashollit Drejtori i DPU-së i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendim Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, shkolla veq është ndërtu dhe skemi qka të shtojmë këtu përveq se me aprovu Vendimin.

Florent Hoxha, edhe ne si grup parlamentar i PDK-së jemi për aprovim të këtij Vendimi mirëpo titullari i pronës është shkolla bujqësore dhe pyes se mos kemi ndonjë pengesë nga titullari i pronës.

Blerim Gashi, në kuadër të këtij Vendimi Gjimnazi po mbetet në dy lokacione dhe si do të veprohet më tutje.

Avni Olluri, e gjithë ajo pjesë e tokës është e shkollës bujqësore dhe nuk ka kurrfar pengese ligjore.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit me 30 vota për Kuvendi miratoi këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR SHKOLLËN E MESME GJIMNAZI “ULPIANA”
LIPJAN

Neni 1

1.1 Me këtë vendim caktohet lokacioni për Shkollën e Mesme Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan në ngastrën kadastrale P-71409044-00846-8 në vendin e quajtur “Bezimeni” me sipërfaqe prej 19057m² të evidentuar në Certifikatën nr.3552/2015 ZK Lipjan, P.Sh Shkolla Bujëqsore Lipjan.

1.2 Ndryshohet emërtimi i titullarit të ngastrës kadastrale P-71409044-00846-8 në vendin e quajtur “Bezimeni” me sipërfaqe prej 19057m² të evidentuar në Certifikatën nr.3552/2015 ZK Lipjan, nga P.Sh Shkolla Bujëqsore Lipjan në Gjimnazin “Ulpiana” Lipjan.

Neni 2

Me këtë Vendim obligohet DGJK-Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e ndyshit-regjistrimit të titullarit nga P.Sh Shkolla Bujëqsore Lipjan në Gjimnazin “Ulpiana” Lipjan siq përcaktohet në nenin 1 par.1.2 të këtij propozim-vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik DGJK-Sektori për Kadastër e Gjeodezi dhe Drejtorati i Arsimit.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VIII

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për shkollën fillore e mesme e ulët
“Emin Duraku” Banullë-Gllgovc

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Ilir Tashollit Drejtor i DPU-së i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendim

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Feriz Hasahi, në Vendim thuhet shkolla e mesme e ulët “Emin Duraku” Banullë-Gllgovc dhe unë e kam të pa kjarët se a është fjala për shkollën e re në Banullë apo për shkollën e vjetër.

Ilir Tasholli, fjala është për shkollën e re në Banullë mirëpo tani për tani emërtimi është “Emin Duraku” Banullë-Gllgovc deri në emërtimin e ri.

Burbuqe Fazliu, ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe e përkrahim në tërësi këtë Vendim.

Edita Gashi, pyeti se nxënëxhit e fshatit Çallapek dhe Bujari ku do t'i vazhdojnë mësimet.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit me 30 vota për Kuvendi miratoi këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR SHKOLLËN FILLORE E MESME E ULËT "EMIN DURAKU" BANULLË-GLLOGOVÇ

Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni për Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Emin Duraku" Banullë-Gllogovç, në ngastrën kadastrale P-71409003-00895-4 në vendin e quajtur "Rosula" me sipërfaqe prej 6605m² të evidentuar në Certifikatën nr.3485/2015 ZK Banullë, Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridi dhe Drejtorati i Arsimit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë:Vendimi.

IX

Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës pasuri-shoqërore e KK-së Lipjan, KB-is (Këshilli i Bashkësisë Islame) për ndërtimin e objektit për të pame për banorët e fshatit Kraishtë

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Basri Hashanit Drejtori i DKRS-së i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendim

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nehat Tërpeza, na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe kërkesa e banorëve të fshatit Kraishtë është me vend dhe na e përkrahim këtë propozim Vendim.

Nazmi Krasniqi, pyeti se prona që është caktu sipas këtij Vendimi a është pronë komunale se kemi ndëgju se aty janë disa konteste.

Basri Hashani, kjo është pronë komunale dhe është vërtetu nga Sektori Pronësoro Juridik

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit me 30 vota për Kuvendi miratoi këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE E KK LIPJAN, KBI-së (KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME) PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR TË PAME PËR BANORËT E FSHATIT KRAISHTË

Neni 1

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim toka-Pasuri Shoqërore e KK Lipjan me sipërfaqe prej 500m², KBI-së (Këshilli i Bashkësisë Islame) në Lipjan, për ndërtimin e objektit për të pame për banorët e fshatit Kraishtë.

Neni 2

Sipërfaqja e tokës sipas pikës 1 të këtij vendimi ndahet nga pjesa e ngastrës kadastrale P71409038-00025-0 në vendin e quajtur “Jazbina”, me kulturë mal i klasës 2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 474147m², e evidentuar në Certifikatën nr.3544/2015 ZK Kraishtë, P.Sh eKuvendit Komunal Lipjan.

Neni 3

Kjo sipërfaqe e tokës si në nenin 1 të këtij Vendimi i ipet në shfrytëzim në afat prej 99 vitesh KBI-së (Këshilli i Bashkësisë Islame) në Lipjan.

Neni 4

Me këtë Vendim obligohet DGJK-Sektori për kadastër dhe gjeodezi, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit në librat publike, KK Lipjan, shfrytëzues për 99 vite KBI-së (Këshilli i Bashkësisë Islame) Lipjan.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik dhe DGJK-Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 16,⁴⁵

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni